

REPUBLIKA E KOSOVËS

DPK/DMP

03-4389/12

02

07-12-2012

Shifra:0599,Nr.11538/2012

Gjykata komunale për kundërvajtje në Ferizaj, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Shpresa Azemi nga Ferizaj, për shkak të veprës kundërvajtëse nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenit 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, e në bazë të neneve 31,73 dhe 195 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më datën 26.11.2012, muarr këtë:

**A K T V E N D I M**

**PEZULLOHET** procedura kundërvajtëse kundër të pandehurës Shpresa Ali Azemi nga Ferizaj, rruga "12 qershori" nr.92, për veprë kundërvajtëse nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenit 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, në mungesë të provave se e pandehura ka kryer veprën kundërvajtëse të ngarkuar si në kërkesën e AKK, konform nenit 198 al.1 pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të kësaj gjykate.

Nga një ekzemplarë i këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

**A r s y e t i m i**

Agjencia kundër korrupsionit në Prishtinë, bëri kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr.01-2216/2012, të dt.04.06.2012, kundër të pandehurës për shkak të kundërvajtjes nga nenet 5.6 paragrafi 1.3 dhe nenit 9 e 17 paragrafi 1.3 të ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar dhe kërkoi që e njëjta të shpallet fajtoare dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtari filloi procedurën kundërvajtëse, morri në pyetje të pandehurën e cila në deklaratën e saj ka theksuar se është e vërtetë që nuk kam bërë deklarimin e pasurisë në Prishtinë për këtë vit për shkak se nuk e kam ditur se kam qenë e obliguar në bazë të ligjit ta bëj këtë se përndryshe do ta kisha bërë këtë lajmërim dhe se për çështje nuk kam qenë e njoftuar nga askush e as nga Naser Musa i cili paska qenë person kontaktues i komunës së Ferizajt me AKK në Prishtinë dhe më tutje ka shtuar edhe atë se posa kam marrë thirrje nga gjykata për këtë çështje unë menjëher të nesermen kam shkuar në AKK në Prishtinë dhe kam bërë deklarimin e pasurisë që si dëshmi për këtë gjykatës i prezantoi vërtetimin nr.03/3693/12 të dt.11.09.2012, gjyqtari pas marrjes së deklaratës së të pandehurës për vërtetim të gjendjes faktike në mënyrë sa më të plotë dhe reale ka marr në pyetje zyrtarin e pikës kontaktuese për ndërlidhjen e punëve me agjencionin kundër korrupsionit të Kosovës pranë Komunës së Ferizajt Naser Musa, zyrtarin tjetër të KK të Ferizajt Afrim Matoshi si dhe shefin e divizionit për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik pranë AKK –së në Prishtinë -Agron Behrami.

Dy dëshmitarët e parë –zyrtarët e komunal të Ferizajt në deklaratat e tyre të cilat i kanë dhënë në gjykatë kanë theksuar se të gjithë këshilltarët komunal të komunës së Ferizajt të cilët kanë qenë prezent në mbledhjen e asamblesë komunale të dt.09.03.2012 kanë pasur në ulëset e tyre formularët e AKK-së për deklarim të pasurisë të cilët në atë ditë ua kemi dorëzuar dhe më tej edhe kryesuesi i atëhershëm i asamblesë komunale në Ferizaj Agim Aliu i cili tani mban postin e kryetarit të komunës i ka informuar këshilltarët e pranishëm në mbledhje se formularët e AKK për deklarim të pasurisë duhet të plotësohen dhe të dorëzohen në AKK në Prishtinë dhe në këtë mbledhje përveq të tjerëve ka qenë prezent edhe e pandehura Shpresa siç shifet nga nënshkrimi i saj në regjistrin e anëtarëve pjesmarrës të KK

